



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i  
Tehnologiju-Ministry of Education Science &Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 8 /2017 PËR INSTITUTIN PEDAGOGJIK TË KOSOVËS

ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MONT) BR. 8 /2017 O PEDAGOŠKOM INSTITUTU KOSOVA

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MEST) NO. 8 / 2017 FOR KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

<p>Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), në bazë të nenit 7, paragrafit 2.5, dhe nenit 11 të Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, (Gazeta zyrtare nr. 11 / 02 maj 2013), si dhe duke u bazuar në nenin 8, paragrafin 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nenit 38, paragrafit 6, të Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011 (Gazeta zyrtare nr. 15, 12.09.2011, nxjerr:</p>	<p>Ministry of Education, Science and Technology (MEST), under the Article 7, paragraph 2.5, and Article 11 of the Law on Scientific-Research Activities (Official Gazette No. 11/02 May 2013), and based on Article 8, paragraph 1.4 and Appendix 6 of the Regulation no. 02/2011 on the areas of administrative responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries (22.03.2011), Article 38, paragraph 6, of the Rules of Procedure of the Government of the Republic of Kosovo no. 09/2011 (Official Gazette No. 15, 12.09.2011), issues:</p>	<p>Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije (MONT), na osnovu člana 7. stav 2.5, i člana 11. Zakona o naučno istraživačkoj delatnosti (Službeni list br. 11/ 2. maj 2013), kao i na osnovu člana 8. stav 1.4 i Priloga 6 Uredbe br. 02/2011 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava (22.03.2011), člana 38. stav 6. Pravilnika o radu Vlade br. 09/2011 (Službeni list br. 15, 12.09.2011, donosi:</p>
<p style="text-align: center;"><b>UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHT) NR. <u>8</u> PËR INSTITUTIN PEDAGOGJIK TË KOSOVËS</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MEST) NO. <u>8</u> / 2017 FOR KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MONT) BR. <u>8</u> O PEDAGOŠKOM INSTITUTU KOSOVA</b></p>
<p>NR. <u>8</u> DT. <u>21.07.2017</u></p>	<p>NO. <u>8</u> DT. <u>21.07.2017</u></p>	<p>BR. <u>8</u> DT. <u>21.07.2017</u></p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b></p> <p>Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që me dispozita të përcaktohen: pozita juridike, parimet, veprimtaria, funksionet, organizimi dhe qeverisja e Institutit Pedagogjik të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm INSTITUTI);</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 1</b> <b>Purpose</b></p> <p>The purpose of this Administrative Instruction is that with the provisions to determine: legal position, principles, activity, functions, organization and governance of the Kosovo Pedagogical Institute (hereinafter the INSTITUTE);</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 1</b> <b>Cilj</b></p> <p>Cilj ovog Administrativnog uputstva je da se odredbama utvrđuju: pravno stanje, principi, delatnost, funkcije, organizovanje i upravljanja Pedagoškog instituta Kosova (u daljem tekstu: INSTITUT);</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b> <b>Statusi Juridik</b></p> <p>1. Institutu është institucion i pavarur publik, kërkimor-shkencor, i themeluar nga MASHT-i, në pajtim me legjislacionin në fuqi;</p> <p>2. Institutu e ka selinë në Prishtinë;</p> <p>3. Institutu e ka cilësinë e personit juridik;</p> <p>4. Institutu e ka vulën e vet të rrumbullakët dhe vulën katrore, si dhe logon, e cila vihet në shkresa si dhe në të gjitha publikimet shkencore të tij;</p> <p>5. Forma dhe përmbajtja e vulave përcaktohen sipas UA të Qeverisë së Kosovës, kurse përmbajtja e logos përcaktohet me vendim të veçantë, të propozuar nga drejtori i Institutit dhe të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2</b> <b>Legal Status</b></p> <p>1. The Institute is an independent public, scientific-research institute, established by MEST, in compliance with the legislation in force;</p> <p>2. The Institute is headquartered in Prishtina;</p> <p>3. The Institute has the capacity of a legal entity;</p> <p>4. The Institute has its own round stamp and square stamp, and its logo, which is put in paperwork and in all its scientific publications;</p> <p>5. Form and content of the stamps is determined by the AI of the Kosovo Government, while the content of the logo is determined by a special decision, proposed by the director of the Institute</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2</b> <b>Pravni status</b></p> <p>1. Institut je nezavisna javna institucija za naučno istraživanje, osnovan od strane MONT-a, u skladu sa zakonodavstvom na snazi;</p> <p>2. Institut ima sedište u Prištini;</p> <p>3. Institut ima svojstvo pravnog lica;</p> <p>4. Institut ima svoj okrugli pečat i kvadratni pečat, kao i logo, koja se stavlja na dopise, kao i u svim svojim naučnim publikacijama;</p> <p>5. Oblik i sadržaj pečata se utvrđuju prema AU Vlade Kosova, dok sadržaj logoa se utvrđuje posebnom odlukom, predloženom od strane direktora Instituta i usvojenom i potpisanom od strane rukovodioca</p>

<p>miratuar e nënshkruar nga udhëheqësi i Këshillit Drejtues të Institutit;</p>	<p>and approved and signed by the Head of the Steering Council of the Institute;</p>	<p>Upravnog odbora Instituta;</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b> <b>Veprimtaria kërkimore-shkencore</b></p> <p>1. Veprimtaria e Institutit është publike, kërkimore dhe shkencore, nga lëmi i edukimit, e cila realizohet përmes punës krijuese sistematike që ndërmerret me qëllim të zhvillimit të njohurive të reja, shfrytëzimit e zbatimit të tyre në praktikë.</p> <p>2. Veprimtaria e Institutit është specifike dhe e orientuar në zhvillimin e edukimit nëpërmjet: hulumtimeve, analizave, krahasimeve, vlerësimeve dhe mbështetjes brenda veprimtarisë së tij.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3</b> <b>Scientific-research activity</b></p> <p>1. The Institute's activity shall be public, scientific and research in the field of education, which is conducted through creative systematic work that is undertaken in order to develop new knowledge and use and implement it in practice.</p> <p>2. The Institute's activity shall be specific and oriented towards development of education through: research, analysis, comparisons, assessments and support within its activity.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3</b> <b>Naučno-istraživačka delatnost</b></p> <p>1. Delatnost Instituta je javna, naučna i istraživačka iz oblasti obrazovanja, koja se realizuje kroz sistematski stvaralački rad koji se preduzima u cilju razvijanja novih znanja, njihovog korišćenja i primene u praksi.</p> <p>2. Delatnost Instituta je specifična i usmerena prema razvoju obrazovanja kroz: istraživanja, analiza, poređenja, procena i podrške u okviru svoje delatnosti.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Realizimi i veprimtarisë themelore dhe specifike</b></p> <p>1. Veprimtaria themelore e Institutit realizohet nëpërmjet punës krijuese e sistematike që ndërmerret me qëllim të kërkimit dhe të zhvillimit të njohurive të reja në fushën e edukimit, nëpërmjet:</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4</b> <b>Realization of basic and specific activity</b></p> <p>1. Basic activity of the Institute shall be accomplished through creative and systematic work that is undertaken for the purpose of research and development of new knowledge in the field of education, through:</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 4</b> <b>Realizacija osnovne i specifične delatnosti</b></p> <p>1. Osnovna delatnost Instituta realizuje se kroz sistematski i stvaralački rad preduzet u cilju istraživanja i razvoja novih znanja u oblasti vaspitanja, kroz:</p>

<p>1.1. Përgatitjes, hartimit dhe realizimit të projekteve të ndryshme kërkimore-shkencore;</p> <p>1.2. Publikimit të rezultateve kërkimore-shkencore, botimit të revistave dhe botimeve të veçanta, organizimit të konferencave dhe aktiviteteve të ndryshme shkencore, si: tryeza, sesione, simpoziume etj.</p> <p>2. Veprimtaria specifike realizohet përmes kërkimeve sistematike në zhvillimin e arsimit si në pjesëmarrjen në edukim/arsimim, në planifikimin shkollor, në standarde dhe vlerësim, në tekstet shkollore, në zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulave, në aftësimin profesional të mësimdhënësve, në shërbimet profesionale dhe veprimtari të tjera, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e arsimit dhe zbatimin të tyre në praktikë.</p> <p>3. Realizimi i veprimtarisë kërkimore themelore dhe specifike mbështetet përmes:</p> <p>3.1 Krijimit të kushteve për formimin dhe ngritjen e kuadrit shkencor (të brendshëm të Institutit) brenda dhe jashtë Kosovës;</p>	<p>1.1. Preparation, drafting and realization of various scientific-research projects;</p> <p>1.2. Publication of scientific-research results, publishing of special magazines and publications, organization of conferences and various scientific activities, such as: roundtables, sessions, symposiums, etc.</p> <p>2. Specific activity of the Institute shall be realized through systematic research in the development of education such as participation in education, school planning, standards and assessment, textbooks, curriculum development and implementation, vocational training of teachers, professional services and other activities, which directly contribute to the development of education and their implementation in practice.</p> <p>3. Realization of basic and specific research activity shall be supported through:</p> <p>3.1. Creating conditions for the establishment and creation of the (Institute internal) scientific cadre within and outside of Kosovo;</p>	<p>1.1. Pripreme, izradu i realizaciju razlicitih naučnih- istraživačkih projekata;</p> <p>1.2. Objavljivanje naučno- istraživačkih istraživanja, izdavanje časopisa i posebnih izdanja, organizovanje raznih naučnih konferencija i aktivnosti, kao što su: okrugli stolovi, sesije, simpozijumi itd.</p> <p>2. Specifična delatnost se realizuje putem sistematskih istraživanja u razvoju obrazovanja kao i u učešću u vaspitanju/ obrazovanju, u školskom planiranju, u standardima i procenama, u udžbenicima, u razvoju i sprovođenja kurikuluma, u stručno usavršavanje nastavnika, u stručne usluge i druge delatnosti koje direktno doprinose razvoju obrazovanja i njihovo sprovođenje u praksi.</p> <p>3. Realizacija osnovnih i specifičnih istraživačkih delatnosti se podržava preko:</p> <p>3.1. Stvaranja uslova za formiranje i razvoj (internog) naučnog kadra (Instituta) unutar i van Kosova;</p>
---	---	---

<p>3.2 Sigurimin e infrastrukturës mbështetëse, si: objektin, pajisjet dhe shërbimet e nevojshme për veprimtarinë kërkimore-shkencore, arkivin, bibliotekën, botimet shkencore, rrjetin e internetit, literaturën elektronike, laboratorët kërkimorë-shkencorë;</p> <p>3.3. Bashkëpunimi me institucionet të tjera kërkimore-shkencore në projektet hulumtuese, si dhe realizimi e veprimtarive të përbashkëta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</p>	<p>3.2 Provision of supporting infrastructure such as: facility, equipment and services necessary for scientific-research activity, archive, library, scientific publications, internet network, electronic literature, scientific-research laboratories;</p> <p>3.3. Cooperation with other scientific-research institutions in research projects, as well as realization of joint activities at national and international level.</p>	<p>3.2 Obezbeđivanja prateće infrastrukture, kao što je: objekat, oprema i potrebne usluge za istraživačke delatnosti, arhiva, biblioteka, naučna izdanja, internet mreža, elektronska literatura, naučno-istraživačke laboratorije;</p> <p>3.3. Saradnje sa drugim naučno-istraživačkim institucijama u istraživačkim projektima kao i realizacija zajedničkih delatnosti na nacionalnom i međunarodnom nivou.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b></p> <p><b>Bashkëpunimi me institucione të tjera</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5</b></p> <p><b>Cooperation with other institutions</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 5.</b></p> <p><b>Saradnja sa drugim institucijama</b></p>
<p>1. Bashkëpunon me MASHT-in dhe institucionet e tjera për problematikat dhe politikat e reja në fushën e edukimit që janë në interes publik brenda fushëveprimtarisë së Institutit.</p> <p>2. Bashkëpunon me institucione të tjera vendore dhe ndërkombëtare, të cilat kryejnë veprimtari të ngjashme.</p>	<p>1. It shall cooperate with MEST and other institutions on new issues and policies in the field of education that are of public interest within the scope of the Institute.</p> <p>2. It shall cooperate with other local and international institutions that carry out similar activities.</p>	<p>1. Sarađuje sa MONT-om i drugim institucijama za nove probleme i politike u oblasti obrazovanja koja su u javnom interesu u okviru delokruga Instituta.</p> <p>2. Sarađuje sa drugim domaćim i međunarodnim institucijama, koje obavljaju slične delatnosti.</p>
<p>3. Sipas kërkesave të MASHT-it dhe</p>	<p>3. According to MEST and other</p>	<p>3. U skladu sa zahtevima MONT-a i drugih</p>

<p>institucioneve të tjera, lidh marrëveshje të bashkëpunimit për realizimin e projekteve të veçanta në fushën e edukimit.</p>	<p>institutions' requirements, it shall conclude cooperation agreements for accomplishment of special projects in the field of education.</p>	<p>institucija, zaključuju sporazume o saradnji za realizaciju posebnih projekata u oblasti obrazovanja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Veprimtaria në rrethana të jashtëzakonshme</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Activities under extraordinary circumstances</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6.</b> <b>Delatnost u izuzetnim okolnostima</b></p>
<p>Instituti mund të ushtrojë veprimtari në rrethana të jashtëzakonshme, në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Veprimtari kërkimore-shkencore, nr. 04/L-135, të datës 28.03.2013.</p>	<p>The Institute may engage in extraordinary circumstances, in accordance with Article 20 of the Law on Scientific-Research Activities, no. 04/L-135, dated 28.03.2013.</p>	<p>Institut može obavljati delatnosti u izuzetnim okolnostima, u skladu sa članom 20. Zakona o naučno istraživačkoj delatnosti, br. 04/L-135, od 28.03.2013.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Parimet e punës së Institutit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Work principles of the Institute</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7.</b> <b>Principi rada Instituta</b></p>
<p>1. Puna e Institutit bazohet në këto parime: 1.1. Lirisë së kërkimeve-shkencore dhe të krijimtarisë; 1.2 Profesionalizmit dhe ligjshmërisë së punës kërkimore-shkencore; 1.3 Mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale; 1.4 Drejtësisë dhe paanësisë, ku çdo anëtar i stafit të Institutit trajtohet në mënyrë të ndershme dhe të paanshme;</p>	<p>1.The work of the Institute shall be based on these principles: 1.1. Freedom of scientific-research and creativity; 1.2 Professionalism and legitimacy of scientific-research work; 1.3 Protection of Intellectual Property Rights; 1.4 Justice and equity, where each member of the Institute's staff is treated fairly and impartially;</p>	<p>1. Rad Instituta se zasniva na sledećim principima: 1.1 Sloboda naućnih istraživanja i stvaralaštva; 1.2 Profesionalizam i zakonitost naućno-istraživaćkog rada; 1.3 Zaštita prava intelektualne svojine; 1.4 Pravednost i nepristranost, gde svaki ćlan osoblja Instituta se tretira pošteno i nepristrasno;</p>

<p>1.5 Etikës dhe përgjegjësisë së punonjësve për rezultatet e punës së tyre;</p> <p>1.6 Konfidencialitetit të punës hulumtuese, sepse çdo anëtar i stafit të Institutit ka përgjegjësi për punën e kryer, për dhënien e informacioneve shkencore apo për dëmet që mund t'i shkaktojë institucionit, individit apo çdo subjekti tjetër;</p> <p>1.7 Ndërlidhjes së kërkimeve shkencore me sistemin e edukimit;</p> <p>1.8 Përfshirjes në veprimtarinë shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare;</p> <p>1.9 Transparencës së punës publike, komunikimit me stafin e Institutit, institucionet arsimore dhe partnerët, me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi.</p>	<p>1.5 Employee ethics and responsibility for the results of their work;</p> <p>1.6 Confidentiality of research work, since every staff member of the Institute is responsible for the work done, providing written information, or damages that may be caused to the institution, individual or any other subject;</p> <p>1.7 Correlation of scientific research with the education system;</p> <p>1.8 Involvement in national and international scientific activity;</p> <p>1.9 Transparency of public work, communication with the Institute's staff, educational institutions and partners with whom there is cooperation agreement.</p>	<p>1.8 Etika i odgovornost zaposlenih za rezultate njihovog rada;</p> <p>1.6 Poverljivost istraživačkog rada, jer svaki član osoblja Instituta snosi odgovornost o obavljenom radu, o davanju dopisnih informacija ili štete koje može prouzrokovati Institutu, pojedincu ili bilo kojem drugom subjektu;</p> <p>1.9 Povezanost naučnih istraživanja sa sistemom obrazovanja;</p> <p>1.10 Učešće u domaćim i međunarodnim naučnim delatnostima;</p> <p>1.9 Transparentnost javnog rada, komunikacija sa osobljem Instituta, obrazovnim institucijama i partnerima, sa kojima ima sporazume o saradnji.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Botimet e Institutit</b></p> <p>1. Rezultatet e veprimtarisë së tij kërkimore dhe shkencore Instituti i boton në revistën "Kërkime Pedagogjike" dhe në</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Institute's publications</b></p> <p>1. The Institute shall publish the results of its research and scientific activity in the "Pedagogical Research" magazine and in other scientific magazines;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Izdanja Instituta</b></p> <p>1. Rezultate svoje naučne i istraživačke delatnosti Institut objavljuje u časopisu "Kërkime Pedagogjike (Pedagoška</p>



<p>revistat e tjera shkencore;</p> <p>2.Përveç botimit të revistës nga paragrafi 1, Instituti boton edhe hulumtime të veçanta, përmbledhje dokumentesh nga fusha e edukimit.</p> <p>3.Veprimtaria botuese më gjerësisht rregullohet me Statut dhe rregulloren për veprimtarinë botuese të Institutit.</p>	<p>2.In addition to the publication of the magazine referred to in paragraph 1, the Institute shall also publish special research, summary of documents in the field of education.</p> <p>3.Publishing activity is largely governed by the Statute and the Regulation on the Publishing Activity of the Institute.</p>	<p>istraživanja)" i u drugim naučnim časopisima;</p> <p>2.Pored izdavanja časopisa iz stava 1, Institut izdaje i posebna istraživanja, zbirke dokumenata iz oblasti obrazovanja.</p> <p>3.Izdavačka delatnost je detaljnije uređena Statutom i uredbom o izdavačkim delatnostima Instituta.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Organizimi dhe përbërja e Institutit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Organization and composition of the Institute</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Organizovanje i sastav Instituta</b></p>
<p>1.Instituti punën e vet e organizon në dy departamente:</p> <p>1.1 Departamenti i kërkimeve në edukim;</p> <p>1.2 Departamenti i shërbimeve të përgjithshme.</p>	<p>1.The Institute shall organize its work in two departments:</p> <p>1.6 Department of Research in Education;</p> <p>1.7 Department of General Services.</p>	<p>1.Institut organizuje svoj rad u dva odeljenja:</p> <p>1.1 Odeljenje za istraživanja u obrazovanju;</p> <p>1.2 Odeljenje za opšte službe.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Departamenti i Kërkimeve në Edukim</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Department of Research in Education</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Odeljenje za istraživanja u obrazovanju</b></p>
<p>1.Departamenti i Kërkimeve në Edukim përbëhet nga katër sektorë:</p>	<p>1.The Department of Research in Education shall consist of four sectors:</p>	<p>1. Odeljenje za istraživanje u vaspitanje se sastoji iz četiri sektora:</p> <p>1.1. Sektor za istraživanja u</p>

<p>1.1. Sektori për hulumtime në edukimin parashkollor;</p> <p>1.2. Sektori për hulumtime në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët;</p> <p>1.3. Sektori për hulumtime në arsimin e mesëm të lartë;</p> <p>1.4. Sektori për hulumtime në arsimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin gjatë gjithë jetës.</p>	<p>1.1. Sector for research in preschool education;</p> <p>1.2. Sector for research in primary and lower secondary education;</p> <p>1.3. Sector for research in upper secondary education;</p> <p>1.4. Sector for Research in Vocational Education and Training and Lifelong Learning.</p>	<p>predškolskom obrazovanju;</p> <p>1.2. Sektor za istraživanja u osnovnom i nižem srednjem obrazovanju;</p> <p>1.3. Sektor za istraživanja u visokom srednjem obrazovanju;</p> <p>1.4. Sektor za istraživanja u stručnom obrazovanju i osposobljavanju i doživotnom obrazovanju.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme</b></p> <p>1. Departamentin e Shërbimeve të Përgjithshme e përbëjnë punëtorët e administratës dhe shërbimet e tjera mbështetëse të Institutit dhe ndahet në dy sektorë.</p> <p>1.1. Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme;</p> <p>1.2. Sektori i Publikimeve.</p> <p>2. Organizimi, përgjegjësia dhe kompetencat e departamenteve të Institutit, më gjerësisht përcaktohen me Statut dhe rregullore të brendshme të punës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Department of General Services</b></p> <p>1. The Department of General Services shall consist of administration staff and other support services of the Institute and is divided into two sectors.</p> <p>1.1. Sector of General Services;</p> <p>1.2. Sector of Publications.</p> <p>2. The organization, responsibilities and competencies of the Institute's departments are more broadly defined by the Statute and the internal Rules of Procedure.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Odeljenje za opšte usluge</b></p> <p>1. Odeljenje za opšte usluge sastoji se od radnika administracije i drugih pomoćnih službi, koja se deli na dva sektora.</p> <p>1.1. Sektor za opšte službe;</p> <p>1.2. Sektor za publikacije.</p> <p>2. Organizovanje, odgovornost i ovlašćenja odeljenja Instituta, detaljnije su utvrđene Statutom i unutrašnjim pravilnikom o radu.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Organet drejtuese të Institutit</b></p> <p>1. Organet kryesore të Institutit janë:</p> <p>1.1.Këshilli Drejtues;</p> <p>1.2.Këshilli Shkencor;</p> <p>1.3.Drejtori.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Governing bodies of the Institute</b></p> <p>1. Main bodies of the Institute shall be as follows:</p> <p>1.1. Steering council;</p> <p>1.2. Scientific council;</p> <p>1.3. Director.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Upravni organi Instituta</b></p> <p>1.Glavni organi Instituta su:</p> <p>1.1 Upravni odbor;</p> <p>1.2 Naučni savet;</p> <p>1.3 Direktor.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Njësitë e veçanta profesionale</b></p> <p>Përveç organeve drejtuese, Institutit ka edhe njësi të veçanta profesionale të përcaktuara me nenin 10 dhe 11 të këtij udhëzimi, të cilat funksionojnë me qëllim të operacionalizimit dhe funksionalitetit të punës së tij;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Special professional units</b></p> <p>In addition to the governing bodies, the Institute also has specific professional units defined in Articles 10 and 11 of this Instruction, which function in order to operationalize and functionalize its work;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Posebne profesionalne jedinice</b></p> <p>Osim upravnih organa, Institut ima posebne profesionalne jedinice navedene u članovima 10. i 11. ovog uputstva, koje funkcionišu u cilju operativnosti i funkcionalnosti svog rada;</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Këshilli Drejtues</b></p> <p>1. Këshilli Drejtues është organ kolegjal qeverisës i Institutit, siç përcaktohet me ligj;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>Steering council</b></p> <p>1.Steering Council is a collegial governing body of the Institute, as defined by Law;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Upravni odbor</b></p> <p>1.Upravni organ je kolegijalni upravni organ Instituta, kako je utvrđeno zakonom;</p>

<p>2. Këshilli drejtues udhëhiqet nga drejtori i Institutit dhe përbëhet nga 5 anëtar</p> <p>3. Në përbërjen e Këshillit Drejtues të Institutit, përveç drejtorit, i cili e udhëheq këtë organ sipas detyrës zyrtare (ex-officio), dy anëtarë që kanë thirrje shkencore i emëron Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë dhe dy anëtarë të tjerë i përbëjnë përfaqësuesit e departamenteve të Institutit të zgjedhur me votim të fshehtë nga të gjithë punonjësit e Institutit;</p> <p>4. Anëtarët e këshillit drejtues, mund të shkarkohen në të njëjtën procedurë të zgjedhjes ;</p> <p>5. Organizimi dhe puna e këshillit drejtues, përcaktohet me rregullore të veçantë;</p> <p>6. Në të gjitha mbledhjet e KD, mbahet procesverbal;</p> <p>7.Mandati i Këshillit Drejtues zgjat 4 vjet. Anëtarët mund të rizgjidhen vetëm edhe për një mandat.</p>	<p>2.Steering council is led by the Institute director and consists of 5 members;</p> <p>3.In addition to the Director, who manages this body ex-officio, the Steering Council of the Institute consists of 2 members with scientific titles, who are appointed by the Ministry of Education, Science and Technology and 2 other members, appointed by representatives of the Institute’s departments, elected by secret ballot by the employees of the Institute.</p> <p>4.Members of the Steering Council may be dismissed in the same procedure they are appointed.</p> <p>5.The organisation and work of the Steering Council shall be determined by a special regulation;</p> <p>6.Minutes shall be taken in each SC meeting;</p> <p>7.The Mandate of the Steering Council shall last 4 years. Members could be re-elected only for another mandate.</p>	<p>2.Upravnim organom rukovodi direktor Instituta i sastoji se od 5 članova</p> <p>3.U sastavu Upravnog odbora Instituta, pored direktora, koji rukovodi ovim organom po službenoj dužnosti (ex-officio), dva člana koji imaju naučna zvanja imenuje Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije i dva druga člana su predstavnici odeljenja Instituta koji su izabrani tajnim glasanjem od strane svih zaposlenih Instituta;</p> <p>4.Članovi Upravnog odbora mogu biti razrešeni u istom postupku kao što su izabrani;</p> <p>5.Organizovanje i rad Upravnog odbora saveta, utvrđuje se posebnim pravilnikom;</p> <p>6.U svim sastancima UO-a, vodi se zapisnik;</p> <p>7.Mandat Upravnog odbora traje 4 godine. Članovi mogu biti ponovo izabrani samo za još jedan mandat.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Kompetencat e Këshillit Drejtues</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Competences of the Steering Council</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Nadležnosti Upravnog odbora</b></p>
<p>1. Kompetencat e Këshillit Drejtues janë:</p> <p>1.1. Miraton Statutin dhe aktet normative të Institutit;</p> <p>1.2 Ndërmerr masa për organizimin dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të Institutit;</p> <p>1.3 Miraton planin e punës së Institutit;</p> <p>1.4 Miraton planin financiar të Institutit;</p> <p>1.5 Zgjedh dhe shkarkon drejtorin e Institutit, në bazë të propozimit të këshillit shkencor të Institutit.</p> <p>1.6 Kërkon rritje të buxhetit dhe bënë ridestinimin brenda kategorive buxhetore;</p> <p>1.7 Vendos edhe për çështje të tjera në bazë të këtij udhëzimi.</p>	<p>1. Competences of the Steering Council are:</p> <p>1.1 Adopts the statute and normative acts of the Institute;</p> <p>1.2 Undertakes measures for organization and creation of conditions for development of scientific-research activity in the Institute;</p> <p>1.3 Adopts the work plan of the Institute;</p> <p>1.4 Adopts the financial plan of the Institute;</p> <p>1.5 Elects and discharges the Institute's director, based on the proposal of the Institute's scientific council.</p> <p>1.6 Requests increased budget and does reallocation within budget categories;</p> <p>1.7 Decides on other issues, under this instruction.</p>	<p>1. Nadležnosti Upravnog saveta su:</p> <p>1.1. Usvaja Statut i normative akte Instituta;</p> <p>1.2 Preduzima mere za organizovanje i stvaranje uslova za razvoj naučno-istraživačkih delatnosti Instituta;</p> <p>1.3 Usvaja plan rada Instituta;</p> <p>1.4 Usvaja finansijski plan Instituta;</p> <p>1.5 Bira i razrešava direktora Instituta na osnovu predloga naučnog saveta Instituta.</p> <p>1.6 Traži povećanje budžeta i vrši preraspodelu u okviru budžetskih kategorija;</p> <p>1.7 Odlučuje i o drugim pitanjima na osnovu ovog uputstva.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b> <b>Këshilli shkencor</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16</b> <b>Scientific Council</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16</b> <b>Naučni savet</b></p>
<p>1. Këshilli Shkencor është organ profesional i Institutit;</p> <p>2. Detyrat e Këshillit Shkencor janë:</p> <p>2.1. Shqyrton dhe vendos për çështjet shkencore dhe profesionale;</p> <p>2.2. Miraton planin e punës për veprimtari kërkimore-shkencore;</p> <p>2.3. Propozon kandidatin për drejtor të Institutit dhe cakton komisionin për zgjedhjen e drejtorit;</p> <p>2.4. Mbikëqyrë procedurën e zgjedhjes në titujt shkencorë dhe në ata hulumtues;</p> <p>2.5. Shqyrton raportin e punës kërkimore-shkencore të Institutit;</p> <p>2.6. Kujdeset për aftësimin e kuadrove shkencore dhe profesionale;</p> <p>2.7. Vendos edhe për çështje të tjera që për nga rëndësia e tyre profesionale dhe shkencore duhet t'i shqyrtojë Këshilli Shkencor;</p>	<p>1. Scientific council is a professional body of the Institute;</p> <p>2. Scientific council:</p> <p>2.1 Reviews and decides the scientific and professional issues;</p> <p>2.2 Adopts the work plan for scientific-research activities;</p> <p>2.3 Proposes the candidate for director of the Institute and appoints the commission for the election of the director;</p> <p>2.4 Supervises the procedure for election of scientific and research titles;</p> <p>2.5 Reviews the scientific-research work report of the Institute;</p> <p>2.6 Ensures training of scientific and professional staff;</p> <p>2.7 Decides on other issues that, due to their professional and scientific importance, should be reviewed by the Scientific council;</p>	<p>1. Naučni savet je stručni organ Instituta;</p> <p>2. Dužnosti Naučnog saveta su:</p> <p>2.1. Razmatra i odlučuje o naučnim i stručnim pitanjima;</p> <p>2.2. Usvaja plan rada za naučno-istraživačke delatnosti;</p> <p>2.3. Predlaže kandidata za direktora Instituta i određuje komisiju za izbor direktora;</p> <p>2.4. Nadgleda postupak izbora i istraživačkih zvanja;</p> <p>2.5. Razmatra izveštaj naučno-istraživačkog rada Instituta;</p> <p>2.6. Stara se o usavršavanju naučnog i stručnog kadra;</p> <p>2.7. Odlučuje i o drugim pitanjima koja su po njihovom profesionalnom i naučnom značaju treba da razmotra Naučni savet;</p>

<p>2.8. Numri i anëtarëve, përbërja dhe kompetencat e Këshillit Shkencor, përcaktohen me statut;</p>	<p>2.8 The number of members, the composition and powers of the Scientific council are defined by statute;</p>	<p>2.8. Broj članova, sastav i nadležnosti Naučnog saveta utvrđuju se statutom;</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 17</b> <b>Drejtori i Institutit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 17</b> <b>Director of the Institute</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 17</b> <b>Direktor Instituta</b></p>
<p>1. Drejtori është organ drejtues dhe udhëheqës individual i Institutit;</p>	<p>1. Director is the leading body and the individual leader of the Institute;</p>	<p>1. Direktor je upravni organ i individualni rukovodilac Instituta;</p>
<p>2. Drejtor emërohet personi që, krahas kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet t'i përmbushë edhe këto kushte të veçanta:</p>	<p>2. As Director is appointed the person who, in addition to the general conditions provided by Law, shall meet the following special conditions:</p>	<p>2. Za direktora se imenuje osoba koja, pored opštih uslova predviđeni zakonom, mora da ispunjava sledeće posebne uslove:</p>
<p>2.1. Të ketë gradë shkencore të shkencave të edukimit;</p>	<p>2.1 Has a scientific degree in education sciences;</p>	<p>2.1. Da poseduje naučno zvanje pedagoških nauka;</p>
<p>2.2. Të ketë përvojë dhe aftësi të dëshmuara në udhëheqje dhe organizim të punëve kërkimore-shkencore;</p>	<p>2.2 Has proven experience and skills in leading and organizing scientific-research activities;</p>	<p>2.2. Da poseduje iskustvo i dokazane veštine u rukovošenju i organizovanju naučno-istraživačkog rada;</p>
<p>3. Procedura e zgjedhjes së drejtorit, përcaktohet me Ligj dhe me Statut të Institutit.</p>	<p>3. Procedure for election of the director shall be determined by the Law and the Statute of the Institute.</p>	<p>3. Postupak izbora direktora, utvrđuje se zakonom i Statutom Instituta.</p>
<p>4. Kandidati, me rastin e konkurrimit, duhet të paraqesë projektin për zhvillimin e veprimtarisë së Institutit, si dhe të mirëvajtjes së punëve të tjera;</p>	<p>4. The candidate, on the occasion of the competition, must present the project for the development of the Institute activities, as well as progress of other duties;</p>	<p>4. Kandidat, prilikom konkurisanja, mora da predstavlja projekat za razvoj delatnosti Instituta, kao i uredno odvijanje drugih poslova Instituta;</p>

<p align="center"><b>Neni 18</b> <b>Kompetencat dhe detyrat e drejtorit</b></p>	<p align="center"><b>Article 18</b> <b>Competencies and duties of the director</b></p>	<p align="center"><b>Član 18</b> <b>Nadležnosti i dužnosti direktora</b></p>
<p>1.Kompetencat dhe detyrat e drejtorit të Institutit janë:</p> <p>1.1.Udhëheq dhe përfaqëson Institutin dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimitarisë së tij;</p> <p>1.2.Udhëheq Këshillin Drejtues, si dhe përkujdeset për zbatimin e vendimeve të tij;</p> <p>1.3. Kryeson Këshillin Shkencor;</p> <p>1.4. Organizon punën dhe veprimitarinë e Institutit;</p> <p>1.5. Nënshkruan kontratat e punës në Institut;</p> <p>1.6. Është urdhërues dhe përgjegjës për zbatimin e planit financiar të Institutit;</p> <p>1.7.Lidh marrëveshje të ndryshme profesionale me partnerë publikë apo privatë, të brendshëm apo të jashtëm, me qëllim të avancimit të punës së Institutit;</p> <p>1.8. Angazhon partnerë fizikë apo publikë, të brendshëm apo të jashtëm,</p>	<p>1.Competences and duties of the director are:</p> <p>1.1 Leads and represents the Institute and is responsible for the legality of his/her activity;</p> <p>1.2 Leads the Steering Council and ensures the implementation of his/her decisions;</p> <p>1.3 Leads the Scientific Council;</p> <p>1.4 Organizes the work and activity of the Institute;</p> <p>1.5 Signs employment contracts at the Institute;</p> <p>1.6 Orders/commands and is responsible for the implementation of the Institute's financial plan;</p> <p>1.7 Concludes different professional agreements with various public and private partners, internal or external, in order to advance the work of the Institute;</p> <p>1.8 Engages physical or public partners, both internal or external, for</p>	<p>1.Nadležnosti i dužnosti direktora Instituta su:</p> <p>1.1. Rukovodi i zastupa Institut i odgovoran je za zakonitost svoje delatnosti;</p> <p>1.2. Rukovodi Upravnim odborom, kao i stara se za sprovođenje svojih odluka;</p> <p>1.3. Predsedava Naučnim savetom;</p> <p>1.4. Organizuje rad i delatnost Instituta;</p> <p>1.5. Potpisuje ugovore o radu u Institutu;</p> <p>1.6. On je nalogodavac i odgovoran je za sprovođenje finansijskog plana Instituta;</p> <p>1.7. Zaključuje različite profesionalne ugovore sa javnim ili privatnim partnerima, unutrašnjim ili spoljnim, u cilju unapređenja rada Instituta;</p> <p>1.8. Angažuje fizičke ili javne, unutrašnje ili spoljašnje partnere, za</p>




<p>për periudha të caktuara, për realizimin e projekteve, në pajtim me përmbajtjen e projekteve në fjalë;</p>	<p>certain periods, in order to implement project, in accordance with the content of the concerned projects;</p>	<p>određene periode, za realizaciju projekata u skladu sa sadržajem dotičnih projekata;</p>
<p>1.9. Propozon rregulloren e brendshme të Institutit dhe të sistematizimit të vendeve të punës;</p>	<p>1.9 Proposes the internal regulation of the Institute and the systematization of jobs;</p>	<p>1.9. Predlaže unutrašnji pravilnik Instituta i sistematizaciji radnih mesta;</p>
<p>1.10. Drejtori për punën e vet i përgjigjet Këshillit Drejtues në pajtim me dispozitat ligjore dhe me këtë udhëzim të Institutit;</p>	<p>1.10 The director shall give account to the Steering Council as regards to his work, in accordance with the legal provisions and with this instruction of the Institute;</p>	<p>1.10. Direktor o svom radu odgovara Upravnom odboru, u skladu sa zakonskim odredbama i sa ovim uputstvom Instituta;</p>
<p>1.11. Drejtori së paku një herë në vit i paraqet Këshillit Shkencor raport për punën e tij dhe veprimtarinë e Institutit;</p>	<p>1.11 The Director shall submit, at least once a year, to the Scientific Council a report on his work and the activity of the Institute;</p>	<p>1.11. Direktor najmanje jednom godišnje podnosi izveštaj Naučnom savetu o svom radu i delatnošću Instituta;</p>
<p>1.12. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me këtë udhëzim.</p>	<p>1.12 Performs other work as defined by the Law and this instruction.</p>	<p>1.12. Obavlja i druge poslove utvrđene zakonom i ovim uputstvom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 19 Personeli i Institutit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 19 Institute personnel</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 19 Osoblje Instituta</b></p>
<p>1. Instituti e ka personelin udhëheqës, stafin hulumtues-shkencor dhe stafin për shërbime të përgjithshme.</p>	<p>1. The Institute has its leading personnel, scientific-research personnel and the general services personnel.</p>	<p>1. Institut ima rukovodeće osoblje, naučno-istraživačko osoblje i osoblje za opšte službe.</p>
<p>2. Të gjithë të punësuarit në Institut zgjidhen me konkurs publik. Personeli i</p>	<p>2. Personnel in the Institute are elected according to the public competition.</p>	<p>2. Svi zaposleni u Institutu biraju se putem javnog konkursa. Osoblje odeljenja za opšte službe podležu propisima</p>

<p>departamentit për shërbime të përgjithshme u nënshtrohet rregullave të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa stafi tjetër, hulumtuesit dhe punëtorët shkencorë, u nënshtrohen dispozitave të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-shkencore nr. 04/L-135, të datës 28.03.2013;</p>	<p>Personnel of general service department is subject to rules of the Law on Civil Service, while the other scientific and research personnel is subject to provisions of the Law No.04/L-135 on Scientific-Research Activity, dated 28.03.2013;</p>	<p>Zakona o civilnoj službi Kosova, dok drugo osoblje, istraživači i naučni radnici, podležu odredbama Zakona o naučno-istraživačkoj delatnosti br. 04/L-135, od 28.03.2013;</p>
<p>3. Numri i të punësuarve në Institut përcaktohet me organogram dhe rregullore për sistematizimin e vendeve të punës, të miratuar paraprakisht nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave;</p>	<p>3.Number of Institute workers shall be set by an organizational chart and the regulations for systematization of jobs, previously approved by the Ministry of Education, Science and Technology, and Ministry of Finance;</p>	<p>3. Broj zaposlenih u Institutu utvrđuje se organizacionom šemom i pravilnikom o sistematizaciji radnih mesta, prethodno usvojena od strane Ministarstva obrazovanja, nauke i tehnologije, Ministarstva javne uprave i Ministarstva finansija;</p>
<p>4. Titujt shkencorë dhe hulumtues të personelit rregullohen sipas Ligjit për Veprimtari Kërkimore-shkencore nr. 04/L-135, të datës 28.03.2013.</p>	<p>4.Scientific and research titles of the personnel are regulated according to the Law No.04/L-135 on Scientific-Research Activity, dated 28.03.2013.</p>	<p>4. Naučna i istraživačka zvanja osoblja uređuju se Zakonom o naučno-istraživačkoj delatnosti br. 04/L-135, od 28.03.2013.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 20</b> <b>Statuti dhe rregulloret e IPK-së</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 20</b> <b>The statute and regulations of the Institute</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 20</b> <b>Statut i pravilnici PIK-a</b></p>
<p>Instituti punën dhe organizimin e kryen në bazë të legjislacionit në fuqi, këtij Udhëzimi Administrativ dhe akteve të</p>	<p>The Institute shall conduct its work and organization based on the laws in force, this Administrative Instruction and other legal acts, which directly or indirectly</p>	<p>Institut, svoj rad i organizovanje obavlja prema zakonodavstvu na snazi, ovog Administrativnog uputstva i</p>

<p>tjera juridike, të cilat drejtpërdrejt apo tërthorazi ndikojnë në punën dhe veprimtarinë e Institutit.</p>	<p>affect the work and activity of the Institute.</p>	<p>drugih pravnih akata, koji direktno ili indirektno utiču na rad i delatnost Instituta.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 21</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Buxheti dhe financimi i Institutit</b></p> <p>1. Institutit financohet nga buxheti i Kosovës, i cili e ka kodin e vet të nënprogramit buxhetor në kuadër të MASHT-it;</p> <p>2. Institutit mund të financohet edhe nga donacionet e ndryshme të ligjshme, të dhëna në formë donacioni, fonde, organizim të konferencave sipas projekteve të ndryshme nga institucione apo organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, për veprimtari apo aktivitete që lidhen me qëllimin e tij në përputhje me dispozita ligjore në fuqi;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 21</b></p> <p style="text-align: center;"><b>The budget and funding of the Institute</b></p> <p>1. The Institute is funded by the Kosovo budget, and has its own subprogram budget code within MEST;</p> <p>2. The Institute may also be funded by various legitimate donations, allocated as donations, funds, conference organization by different projects from national or international institutions or organizations, for activities related to its purpose in accordance with the applicable legal provisions;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 21</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Budžet i finansiranje Instituta</b></p> <p>1. Institut se finansira iz budžeta Kosova, koji ima svoj pod-programski budžetski kod u okviru MONT-a;</p> <p>2. Institut može da se finansira i od raznih legitimnih donacija koje se daju u obliku donacija, fondova, organizovanja konferencija u okviru različitih projekata od strane nacionalnih i međunarodnih institucija, za delatnost i atktivnosti koje se povezuju sa njegovim ciljem u skladu sa zakonskim odredbama na snazi;</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 22</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Mbikëqyrja administrative dhe financiare e Institutit</b></p> <p>Institutit i nënshtrohet mbikëqyrjes së auditimit në pajtim me ligjislacionin në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 22</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Administrative and financial supervision of the Institute</b></p> <p>The Institute shall be subject of audit supervision in accordance with laws in force.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 22</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Administrativni i finansijski nadzor Instituta</b></p> <p>Institut je predmet nadzora revizije u skladu sa zakonodavstvom na snazi.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 23</b> <b>Konflikti i interesit</b></p> <p>Çdo punonjës i Institutit duhet të zbatojë ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksioneve publike. Punonjësit e Institutit nuk duhet të angazhohen në veprimtari të jashtme që pengojnë kryerjen e detyrës së punës. Në çdo rast duhet të njoftojnë drejtorin e Institutit për çdo veprimtari të jashtme që ata kryejnë. Çdo punonjës ka detyrimin t'u përmbahet kontratës dhe vendimit për angazhim, për mospërfshirje në veprimtari apo në aktivitete që përbëjnë konflikt interesi.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 23</b> <b>Conflict of Interest</b></p> <p>Every employee of the Institute shall apply the Law on prevention of conflict of interest while exercising public functions. Employees of the Institute shall not engage in external activities that impede job performance. In any case, they must notify the director of the Institute of any external activity they perform. Every employee shall be obliged to adhere to the contract and decision for engagement, and not be involved in activities that constitute a conflict of interest.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 23</b> <b>Sukob interesa</b></p> <p>Svaki zaposleni Instituta treba da sprovodi Zakon o suzbijanju sukoba interesa u vršenju javne funkcije. Zaposleni u Institutu ne bi trebalo da se angažuju u spoljne delatnosti koje ometaju obavljanje radnih dužnosti. U svakom slučaju, moraju da obaveste direktora Instituta za bilo koju spoljnu delatnost koju oni obavljaju. Svaki zaposleni ima obavezu da se pridržava ugovora i odluke o angažovanju, za ne uključivanje u delatnost ili aktivnosti koje predstavljaju sukob interesa.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 24</b> <b>Dispozitat shfuqizuese</b></p> <p>Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ i MASHT-it nr. 10/2014, dt. 05.05.2014, për Institutin Pedagogjik.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 24</b> <b>Repealing provisions</b></p> <p>Upon the entry into force of this Administrative Instruction, the Administrative Instruction (MEST) no. 10/2014 on the Pedagogical Institute, dated 05.05.2014, shall be repealed.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 24</b> <b>Ukidajuće odredbe</b></p> <p>Stupanjem na snagu ovog Administrativnog uputstva stavlja se van snage Administrativno uputstvo MONT-a br. 10/2014, od 05.05.2014 o Pedagoškom institutu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b> <b>Dispozitat kalimtare</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 25</b> <b>Transitional provisions</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 25</b> <b>Prelazne odredbe</b></p>

<p>Të gjitha aktet e tjera të Institutit duhet të ndryshohen dhe të harmonizohen me këtë udhëzim, Statut dhe me Ligjin për Veprimtari Kërkimore-shkencore (Gazeta zyrtare nr. 11/02, maj 2013), brenda periudhës gjashtëmujore, nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.</p>	<p>All other acts of the Institute should be amended and harmonized with this instruction, statute and with the Law on Scientific-Research Activities (Official Gazette No. 11/02, May 2013), within the six-month period, following the entry into force of this Instruction.</p>	<p>Svi drugi akti Instituta treba da se izmene i usklade sa ovim uputstvom, statuta i Zakonom o naučno-istraživačkoj delatnosti (Službeni list br. 11/02. maj 2013), u okviru šestomesečnog perioda od dana stupanja na snagu ovog uputstva.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b> <b>Hyrja në fuqi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 26</b> <b>Entry into force</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 26</b> <b>Stupanje na snagu</b></p>
<p>Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ministri.</p>	<p>This Administrative Instruction shall enter into force seven (7) days after its signing by the Minister.</p>	<p>Ovo Administrativno uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon potpisivanja od strane ministra.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Prof. dr. Arsim Bajrami,</b>  <b>Ministër</b></p> <p style="text-align: center;">Prishtinë 21. 07. 2017</p>	<p style="text-align: center;"><b>Prof. Dr. Arsim Bajrami,</b> _____ <i>Minister</i></p>	<p style="text-align: center;"><b>Prof. dr. Arsim Bajrami,</b> _____ <i>Ministar</i></p>